



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Ref: 1809/1048/BA/AH
Nr.06/2018**

BORDI PËR ANKESA, i përbërë nga Avdyll Hyseni, kryetar, Musa Dragusha, dhe Ilaz Rudaku anëtarë, duke vendosur lidhur me Ankesën Nr. 1809/1023/BA/AH të datës 19.09.2018 të parashtruesit “ARTMOTION”, përfaqësuar nga Gent Bekeri, nga Prishtina, të paraqitur kundër Vendimit NR/1809/1017/KPM/mf të datës 18.09.2018 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datë 28.09.2018 mori këtë:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar Ankesa Nr. 1809/1023/BA/AH të datës 19.09.2018 të parashtruesit “Artmotion”, nga Prishtina përfaqësuar nga Gent Bekeri, ANULOHET Vendimi Nr/1809/1017/KPM/mf i datës 18.08.2018 të KPM-së dhe çështja kthehet në rivendosje.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Nr/1809/1017/KPM/mf të datës 18.08.2018, e ka obliguar operatorin e kabllor Artmotion që përkohësisht të bëjë ndërprerjen e transmetimit të të gjitha ngjarjeve sportive të UEFA Champions League dhe UEFA Super Cup dhe UEFA Europa League përmes kanalit Arena Sport deri në konstatimin përfundimtar që të drejtat e transmetimit të kompanive nga Republika e Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, të siguruar mbi bazën e tenderit të shpallur për territorin e Republikës së Serbisë nuk përbëjnë shkelje të kushtetutës si dhe nuk cenojë sovranitetin e Republikës së Kosovës.

Kundër këtij Vendimi, në afatin e paraparë ligjorë, operatori “Artmotion” nga Prishtina me datë 19.09.2018, ka parashtruar ankesë, pran Bordit për Ankesa, për shakë të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të të drejtës materiale, të shkeljes së dispozitave të Ligjit NR 04/L-44 të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe shkeljes së dispozitave të Ligjit Nr 05/ L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me propozim që Bordi për Ankesa ta aprovoj ankesën dhe Vendimin e kundërshtuar ta anuloj.

Bardi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datë 28.09.2018, ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pasi që vlerësoj Vendimin e kundërshtuar, vendosi që, Ankesa duhet të aprovohet, si e bazuar, kurse Vendimi i kundërshtuar të anulohet, e çështja të kthehet në rivendosje.

Bordi konstaton se pretendimet e Palës Ankuese, lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljet ligjore, janë të bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes se vendimit të kundërshtuar, nuk e ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike si dhe nuk e ka aplikuar drejte ligjin material dhe atë procedural.

Sipas vlerësimit të Bordit, Vendimi i kundërshtuar nuk përmban faktet themelore për aplikimin e masës së përkohshme, nuk janë respektuar dispozitat materiale nga neni 6 i Ligjit Nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe me nenet 47 paragrafi 1.1 dhe 1.4, 48 paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Të metat e cekura në vendimin e KPM-së, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së këtij vendimi. KPM duhet që të vërtetoj plotësisht gjendjen faktike si dhe ti mënjanoj shkeljet e evidentuara.

Nga sa u theksuar me lartë, e konform dispozitave të nenit 44 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-44 të Komisionit të Pavarur për Media, si dhe nenin 132 paragrafi 5 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si ne diapozitivin e këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për çështje Administrative, ne afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve
- Arkivit të KPM-së.

